



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 120, datë 27.10.2022

PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË PËR STUDIMIN DHE
PARAQITJEN E MODELIT TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT BUJQËSOR NË TOKAT
PRONËSI SHTETËRORE OSE NË BASHKËPUNIM ME FERMERËT PRIVATË

Në zbatim të pika 1, gërma a, pika 2, e nenit 113, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 2, 3, 9 neni 2, gërma ç neni 3, pika 2 neni 7, pika 1 neni 8, pika 1.1, gërma a, pika 1.4, 1.6 gërma b neni 9, pika 4 neni 27, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit kryetarit të bashkisë për studimin dhe paraqitjen e modelit të zhvillimit të sektorit bujqësor në tokat pronësi shtetërore ose në bashkëpunim me fermerët privatë.
2. Raportimi dhe paraqitja e modelit nga kryetari i bashkisë në Këshillin Bashkiak brenda datës 31.12.2022.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 prot.
11

Durrës, më 09 .11 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.120 datë 27.10.2022 :

Për dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë për studimin dhe paraqitjen e modelit të zhvillimit të sektorit bujqësor në tokat pronësi shtetërore ose në bashkëpunim me fermerët privatë.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

